

NË EMER TË POPULLIT

GJYKTA E APELIT E KOSOVËS- Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët, Abdullah Ahmeti, kryetar i kolegjit, Fillim Skoro, gjyqtar referues dhe Driton Muharremi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi, si procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarit K.P., nga Klina, për shkak të veprave penale, nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore nga neni 432 të KPRK-së, veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPRK-së, veprën penale pastrim i parave të përcaktuar sipas nenit 56 paragrafi 1 të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit dhe veprën penale shmangia nga tatimi nga neni 313 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e të akuzuarit K.P., të ankesës të mbrojtësit të akuzuarit K.P., av.T.Rr. dhe të ankesës përfaqësuesit të palës dëmtuar S.Gj. av.Z.P., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.642/2015, të dt.28.06.2017, me dt.01.11.2017, në seancën publike të kolegjit të mbajtur, me datë 20.11.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.Me aprovimin e dy ankesave të mbrojtësit të akuzuarit K.P. av-T.Rr. dhe vetë akuzuarit, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.642/2015, të dt.28.06.2017, përkitazi me vendimin mbi dënimin dhe konfiskimin e dobisë pasurore, ashtu që Gjykata e Apelit, të akuzuarit K.P. pasurin e konfiskuar shtëpinë prej dy kateve, ne sipërfaqe ne 209^{m2}, e cila evidentohet si parcelë me nr.xxx dhe nr.xxx, Komuna Kadastrale Klinë, dhe tokë bujqësore në sipërfaqe prej 1182^{m2}, e regjistruar në certifikatën e pronësisë ULxxx, e më afër të përshkruar si në dispozitivin III, pasusi pesë, i aktgjykimit i kthehen në posedim të akuzuarit, ndërsa për veprën penale nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore nga neni 432 të KPRK-së, e më afër të përshkruar si në dispozitivin I të aktgjykimit dënimin e shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti e 6(gjashtë)muaj e merr si të vërtetuar, për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPRK-së, e më afër të përshkruar si në dispozitivin II të aktgjykimit, dënimin e shqiptuar në kohëzgjatje prej 2(dy)viteve burgim, e merr si të vërtetuar, ndërsa për veprën penale të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, nga neni 56 par.1, ia përcakton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1(një)vit e 6(gjashtë)muaj dhe dënimin me gjobë në shumë prej 3.000(tremijë)Euro dhe në bazë të nenit 80 par.2 nën par.2.2 të KPRK, ia shqipton dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 3(tre)vite e 6(gjashtë)muaj dhe dënimin me gjobë në shumë prej 3.000(tremijë)Euro, e të cilin dënim i akuzuari do të paguaj në afat prej 15 ditëve, pasi që

aktgjykimi të merr formën e prerë. Nëse dënimin me gjobë nuk e paguan në afatin e caktuar dhe e njëjta nuk mund të nxjerrët edhe me detyrim, atëherë dënimi i shqiptuar me gjobë do të zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që çdo 20Euro, do të i llogaritet një ditë burgim.

II. Hudhet poshtë si e pa lejuar ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar S.Gj., av.Z.P., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.642/2015, të dt.28.06.2017.

III. Aktgjykimi në pjesët tjera mbetet i pa prekur.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore DRK në Prishtinë, PKR.nr.642/2015, i dt.28.06.2017, i akuzuari K.P., është shpallur fajtor për veprat penale të ricilësuar nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore nga neni 432 të KPRK-së, veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPRK-së, veprën penale pastrim i parave të përcaktuar sipas nenit 56 paragrafi 1 të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, për të cilat vepra penale është gjykuar për veprën penale nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 18(tetëmbëdhjetë)muaj, respektivisht 1(një)vite e 6(gjashtë)muaj, për veprën penale nën pikën II të dispozitivit të aktgjykimit i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 24(njëzetekatër)muaj, respektivisht 2(dy)vite burgim, për veprën penale nën pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 18(tetëmbëdhjetë)muajve, respektivisht 1(një)viti e 6(gjashtë)muaj burgim. Pastaj gjykata në bazë të nenit 80 të KPPRK, të akuzuarit K.P. për veprat penale nën pikat I, II e III të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqipton dënimin unik me burgim, duke ia vërtetuar dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 54(pesëdhjetekatër)muaj, respektivisht 4(katër)vite e 6(gjashtë)muajve, si dhe për veprën penale të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, i është shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 5.000(pesëmijë)Euro, të cilin dënim i akuzuari do të paguajë në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe se dënimin me gjobë nuk mund ta nxjerr edhe me detyrim, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësoj me dënim me burgim duke ia llogaritur çdo 20Euro, me një ditë burgim apo gjithsejtë 250(dyqindepesëdhjetë)ditë burgim.

Të akuzuarit K.P. për veprën penale nën pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 5.000(pesëmijë)Euro, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se dënimi me gjobë nuk realizohet as detyrimisht nga i akuzuari, gjykata këtë dënim do ta zëvendësoj të akuzuarit me dënim me burgim duke llogaritur 20(njëzet)Euro, për një ditë burgimi, respektivisht me 250(dyqindepesëdhjetë)ditë burgim.

Ndaj të njëjtit është shqiptuar dënimi plotësues, ndalimi i ushtrimit të funksioneve publike dhe profesionit të avokatit.

Të akuzuarit i ndalohet ushtrimi i funksioneve në administratën publike ose në shërbime publike si dhe i ndalohet ushtrimi i profesionit të avokatit, në kohëzgjatje prej 3(tri)viteve, duke filluar nga dita e përfundimit të mbajtjes(ekzekutimit) të dënimit me burgim.

Ndaj të akuzuarit janë konfiskuar sendet si rezultat/përfitim nga kryerja e veprës penale dhe atë:

Banesë në Klinë në rr. “Dëshmorët e Kombit”, banesa nr.6, Hyrja 2, Kati 1, Blloku P+3, në sipërfaqe prej 36^{m2}, e blerë sipas kontratës së datës 17.04.2003, e vërtetuar në gjykatë nën numrin Vr.nr.629/2003, shitës P.Z. ndërsa blerës K.P., në çmimin e përgjithshëm prej 12.000Euro.

Banesë në Prishtinë, Lagjja “Ulpiana”; në Prishtinë, objekti E-30, Lamela 1, banesa nr.4, kati përdhese, në sipërfaqe prej 97.30^{m2}, e blerë sipas kontratës Vr.nr.9859/2007, e dt.09.11.2007, e lidhur ndërmjet A.J., si shitës dhe L.P., si blerës i banesës në vlerë prej 125.000Euro.

Patundshmërinë (në të cilën është e ndërtuar një shtëpi) në Ulqin, të Malit të Zi, në sipërfaqe prej 308^{m2}, parcela nën numrin 108 Zona kadastrale në Ulqin, patundshmëri e blerë nën kontratën me numër 3852/2006, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Ulqin, e lidhur me dt.08.09.2006, ndërmjet K.P., si blerës dhe Zh.B., si shitës, e cila patundshmëri është transferuar në emër të mikut të K.P., I.G., me qëndrim në Australi.

Patundshmëri (livadh) në Ulqin të Malit të Zi, në sipërfaqe prej 171^{m2}, parcela nën numrin 107 Zona Kadastrale Ulqin, patundshmëri e blerë me kontratën me numër 3191/2006, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Ulqin, e lidhur me dt.07.08.2006, ndërmjet K.P., si blerës dhe B.P., si shitës, e cila patundshmëri është regjistruar në emër të babait të K.P., Z.P..

Shtëpinë prej dy kateve e cila gjendet në rr.”Mehdi Morina”, në Klinë, në sipërfaqe prej 209^{m2}, evidentuar si parcela nën numrin xxx dhe xxx, Komuna Kadastrale Klinë, si dhe tokë bujqësore në sipërfaqe prej 1182^{m2}, e regjistruar në Certifikatën e Pronësisë UL-71006024-00916, e cila tani figuron në emër të T.P. (vëllait të K.P.).

Lokal afarist i cili gjendet në rr. “Dëshmorët e Kombit”, në Klinë, lamela A, banesa nr.1, Kati përdhese, në sipërfaqe prej 39.86^{m2}, e blerë sipas kontratës së vërtetuar në Gjykatën Komunale në Klinë, nën numrin Vr.nr.1771/2005, e dt.01.11.2005, lidhur ndërmjet K.P., si blerës dhe S.Gj., si shitës, e cila tani figuron në emër të T.P.(vëllait të K.P.).

AuT.jeti “Audi A6”, me targa të regjistrimit 03-310-A1, i blerë nga K.P., i cili gjendet në emër të mikut të K.P., K.G..

Mjetet financiare nga shtija e dy lokaleve afariste, paraprakisht të blerë nga K.P., në vlerë prej 35.000Euro, për njërin lokal dhe 28.000Euro, për lokalin tjetër.

Të dëmtuarit B.B., A.Z.,L.Sh.,B.H.,S.Gj.,A.T.,M.Gj.,S.Gj.,H.B.,Gj.B.,S.G.,K.N.,H.A., A.F., T.B.,Z.H.,M.P. dhe A.G., N.N. ,Ag. G. ,I.K., A.L., F.C., F.N., N.B., H.M., S.G., P.M., A.M., M.D., F.V., N.D.,I.B.,F.G.,A.D., Bs.B., S.M., Q.G., B.D., M.B. dhe J.N., për realizimin e kërkesë pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil, ndërsa S.G. dhe M.D., në seancën e

kolegjit kanë deklaruar se nuk janë të dëmtuar dhe nuk kanë parashtruar kërkesë pasurore juridike.

Obligohet i akuzuari K.P., të paguaj shpenzimet e kësaj procedure penale në shumë prej 150Euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor, ankesë kanë paraqitur:

I akuzuari K.P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, vendimit mbi dënimin dhe konfiskimin e dobisë pasurore, me propozim që Gjykata e Apelit, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe çështjen penale ta kthejë në rigjykim dhe vendim, ose që aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj edhe në bazë të nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPP, të akuzuarin ta liroj nga akuza, në mungesë të provave.

Mbrojtësi i të akuzuarit K.P., av.T. Rr., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, vendimet mbi sanksionet penale dhe konfiskimin e dobisë pasurore, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoj ankesën, të ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarin në bazë të nenit 390 par.1 nën par.1.3 të KPP, ta liroj nga akuza për arsye se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale ose që aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen penale t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendim.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën PPA/I.nr.456/17, të dt.23.10.2017, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e të akuzuarit K.P., të mbrojtësit të tij, av.T. Rr., e duke vepruar edhe sipas detyrës zyrtare në pajtim me dispozitën e nenit 394 par.1 të KPP, duke marrë parasysh edhe mendimin me shkrim të Prokurorisë së Apelit, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe shkresave të lëndës gjeti se:

Ankesa e të akuzuarit K.P. dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit K.P., janë pjesërisht të bazuara.

Gjykata konform nenit 390 par.4 të KPPK, mbajti seancën e kolegjit, në të cilën prezantuan i akuzuari K.P., mbrojtësi i tij, av.T.Rr., të dëmtuarit Bs.B., A.Z., L.Sh., B.H. dhe përfaqësuesi i tij, av.D.K., S.Gj., A.T., M.Gj., S.Gj., H.B. Gj.B., S.G., K.N., H.A., A.F., T.B.,Z.H.,M.P.,A.G.,S.G.,M.D., ndërsa nuk prezantuan, përfaqësuesi i të dëmtuarit S.Gj., av.Z.P. dhe të dëmtuarit N.G.,Ag.G.,I.K.,A.L.,F.C.,F.N.,S.M.,I.B.,F.G.,Q.G.,A.D.,P.M.,A.M.,F.V.,N.D. edhe pse të gjithë ishin të njoftuar në mënyrë të rregullt, nuk ka marrë pjesë edhe Prokurori i Apelit-DKR në Prishtinë i cili ishtenjoftua më mënyrë të rregull, dhe me propozimin me shkrim është deklaruar se ankesa e të akuzuarit K.P. dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit , av.T.Rr., të refuzohen si të pabazuara, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të vërtetohet.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

Në dy ankesat e mbrojtësit të akuzuarit, dhe në ankesën e të akuzuarit K.P., pretendimet ankimore janë të njëjta apo të ngjashme (përveç se në ankesën e të akuzuarit K.P. pretendimet ankimore kanë të bëjmë në tepër me konfiskimin e dobisë pasurore).

Në të dy ankesat pretendohet se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale (në ankesën e të akuzuarit K.P. edhe për shkak të shkeljeve esenciale të natyrës relative nga neni 384 par.2 të KPP). Në të dy ankesat theksohet se gjykata nuk ka dhënë arsye për çdo pikë të aktgjykimit dhe nuk bënë analizimin në mënyrë të qartë dhe të plotë, të fakteve relevante lidhur me provat të cilat janë nxjerrë në shqyrtimin gjyqësor se cilat prova i kanë marrë si të besueshme, si dhe nuk ka miratuar propozimet për sigurimin e origjinaleve të provave. Gjukata nuk ka vërtetuar se aktgjykimi C.nr.54/2000, është evidentuar në regjistrin e lëndëve civile në Gjykatën Komunale në Klinë dhe ky aktgjykim është tërësisht i falsifikuar. Në ankesa pretendohet se aktgjykimi i cekur më lart edhe po të ishte falsifikuar nga i akuzuari K.P., nuk do të bëhej fjalë për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor. Vepra penale nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësor kryhet nga gjyqtari gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare në një procedurë gjyqësor të cilën e zbaton gjyqtari në kuadër të detyrave dhe autorizimeve ligjore. Në çështjen penale sipas pretendimeve ankimore nuk bëhet fjalë për nxjerrjen e aktgjykimit të kundërligjshëm në procedurë gjyqësor, por për aktgjykimit tërësisht të falsifikuar dhe nga kjo del se gjykata nuk ka dhënë fakte vendimtare lidhur me ekzistimin apo mos ekzistimin e kësaj vepre penale. Edhe dispozitivi II i aktgjykimit është i pa qartë, i pa kuptueshëm, për arsye se i akuzuari si gjyqtar ka përdorë vulën zyrtare të Gjykatës Komunale në Klinë duke i vulosur 19 autorizime falsifikuar për përfaqësim ligjor, edhe përkundër faktit se personat në fjalë –të dëmtuarit nga aksidentet e trafikut nuk kanë dhënë pëlqim për përfaqësimin e tyre dhe ky dispozitiv i aktgjykimit është krejtësisht i pa qartë për arsye se gjykata nuk ka vërtetuar veprimet e të akuzuarit se kur i ka vulosur me vulën e gjykatës, cili nga autorizimet e falsifikuar dhe në emër të cilit person të dëmtuar. Sipas pretendimeve ankimore të cekura në ankesa të gjitha këto veprime janë kryer para dt.28.06.2007, e që ka arritur parashkrimin absolut të ndjekjes penale. Gjukata ka shkelur edhe të drejtën kushtetuese të akuzuarit K.P., për arsye se dyshimet bërë janë të pa vërtetuara, dhe është dashur të interpretojnë në favor të akuzuarit.

Sipas ankesave në arsyetim të aktgjykimit nuk janë dhënë arsye lidhur me pretendimet e mbrojtjes të paraqitura në fjalën përfundimtare, e me vet faktin se gjykata nuk ka vlerësuar në mënyrë të veçantë saktësinë e provave kundërtëhënëse dhe nuk ka dhënë arsye të qarta lidhur me vlerësimin e provave, lidhur me faktet vendimtare. Ankesa pretendon se aktakuza e prokurorit të shtetit është e pabazuar për arsye se në shqyrtimet gjyqësore nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari K.P., ka kryer vepra penale për të cilat është shpallur fajtor.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit pretendohet se nuk janë respektuar dispozitat e nenit 31 të Republikës së Kosovës, Konventat e me qëllim që të bëhet sigurimi nga arbitrariteti dhe transparenca për sigurimin e drejtësisë, si dhe ankesa thirret edhe në vendimet e gjykatës për të drejtat e njeriut, e me detyrimin kushtetues që gjykata në Republikën e Kosovës, të interpretojë të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe me vendimet e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut.

Në ankesë pretendohet se gjykata me asnjë provë nuk ka pretenduar dashjen e të akuzuarit për kryerjen e veprave penale për të cilat i akuzuari është shpallur fajtor. Sipas ankesës aktgjykimi i falsifikuar C.nr.285/2005, mban emrin e të akuzuarit K.P., si kryetar i trupit

gjykues, mirëpo, i njëjti aktgjykim nuk është nënshtruar ekspertimin grafik. Gjykata për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, asnjë nga dëshmitarët në gjykimin paraprak e as me ekspertizën grafologjike të ekspertëve H.K. dhe V.M., të administruar si provë në këtë shqyrtim gjyqësor nuk vërtetojnë nënshkrimi sipër vulave të jetë i K.P. dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, mbështetë në fotokopjet e provave, e të cilën gjë, mbrojtja e ka kërkuar që të sigurohen origjinalet e lëndëve për kompensim dëmeve të dorëzuara në kompaninë e sigurimeve “Kosova”, e cila ka qenë në likuidim për fshirë, kërkesat për kompensimin e dëmin, ujdite jashtë gjyqësore dhe shkresat tjera të lëndë, me qëllim që të vërtetohet kush i ka dorëzuar kërkesat në kompani.

Në ankesa pretendohet se 19 autorizime, të cilat janë të falsifikuara për përfaqësim ligjor, duke i vulosur me vulën e Gjykatës Komunale në Klinë, i akuzuari K.P., nuk do të mund të përgjigjej penalisht për këtë vepër penale për arsye se këto veprime nuk janë ndërmarr në kuadër të ushtrimit të detyrimeve të tija si gjyqtar i kësaj gjykate, por krejtësisht jashtë këtyre detyrave dhe autorizimeve dhe në një situatë të tillë nuk manifestohen elementet e veprës penale për të cilën i akuzuari K.P. është shpallur fajtor, e cila është cekë edhe të shkeljet esenciale, e edhe në bazën ankimore të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ku dëshmitari H.M., në deklaratën e tij ka deklaruar se ai ka qenë i ngarkuar me vulën nr.2, në ish Gjykatën Komunale në Klinë. Nga kjo del se 19 autorizimet e falsifikuara, të jenë formular dhe se ato të jenë plotësuar nga i akuzuari, mirëpo, nuk ka të bëjë asgjë se ai ka bërë këto veprime i ka kryer në kuadër të detyrave të punës ose autorizimeve të tija si gjyqtar. Gjykata e shkallës së parë, nuk ka vërtetuar nënshkrimin sipër vulës a është i të akuzuarit K.P. dhe kjo sipas vet deklaratës së të akuzuarit K.P., është bërë nga tani i ndjeri H.H.. Sipas ankesës lidhur me veprën penale të pastrimit të parave, e për të cilën vepër penale i akuzuari është shpallur fajtor, sipas dispozitës së nenit 56 të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, në kohën kur është kryer vepra penale, kjo nuk ka qenë e paraparë me ligj si vepër penale, e me të cilën është shkelur parimi themelor se askush nuk mund të shpallet fajtor për veprën penale e cila nuk është paraparë me ligj, si vepër penale. Ankesa pretendon se të gjitha vendimet e gjykatës mbi konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar me vepër penale, të gjitha shitblerjet e përfshirë me vendimin për konfiskim kanë ndodhur para se kjo vepër penale të parashihet me ligj, si vepër penale dhe të përcaktohet sanksioni penal për këtë vepër penale. Në ankesë pretendohet se blerja e drejtpërdrejtë e sendeve të luajtshme apo të pa luajtshme, me dobinë pasurore të përfituar me vepër penale, vetvetiu nuk përbën vepër penale, me elementet të veprave penale të pastrimit të parave, pastrim i parave konsiderohet kur kryesi i veprës penale dobinë pasurore të përfituar e investon në veprimtari ilegale, ndërsa përfitimin e ligjshëm ose e bartë në gjiro llogarinë e personave të tjerë dhe ajo pastaj kthehet si pasuri e trashëguar si dhuratë, si kthim borxhi. Në të dy ankesat pretendohet edhe gjendja faktike se nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe disa nga pretendimet ankimore lidhur me gjendjen faktike janë paraqitur në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe në ankesë pretendohet se K.P., i ka plotësuar pjesërisht me shkrim dore 19 autorizime, 11, për të cilat në emër të Z.M. dhe 8 tjera në emër të tij, por auto autorizime nuk janë vulosur, as nuk janë nënshkruar dhe nga gjendja faktike e cila nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë, në veprimet e të akuzuarit K.P., nuk manifestohen elementet qenësore të veprave penale për të cilat ai është shpallur fajtor.

Sipas ankesave të paraqitura gjykata nuk ka vlerësuar mbrojtjen e të akuzuarit në mënyrë të drejtë se me të ndjerin H.H., janë njohur në bazë të përfaqësimeve që i ndjeri H.H., kishte pasur Gjykatën Komunale në Klinë, por nuk kanë pasur ndonjë marrëdhënie të afërt dhe nuk kanë pasur lista të ndërsjella dhe i ndjeri Hilmi, i kishte kërkuar K.P. që ti mundësohet të gjej

persona në mënyrë të shumat e parave në emër të kompensimeve të dëmeve për (disa njerëz të tij), ti depoziton në xhirollogarinë e tij, pasi që ky nuk mund ti deponoj në xhirollogarinë e vet, për arse se ishte likuidator i kompanisë “Kosova”, e cila ishte në likuidim dhe të akuzuarit K.P., i kishte garantuar se nuk do të ketë asnjë problem, ndërsa të akuzuarit K.P., do ti paguhet një shpërblim prej 150 Euro, për secilin rast veç e veç, e të cilin propozim të ndjerit e ka pranuar i akuzuari K.P., pasi që kishte autorizimin në xhirollogarinë e Z.M. në “Procredit Bank” në Prishtinë ku i kishte thënë të deponoj në xhirollogarinë e tij. Ankesa pretendon se ka ekzistuar marrëveshja në mes të K.P. dhe Z.M., ku ishte hapur një llogari bankare në “Procredit Bank” dhe të akuzuarit K.P., i ishte dhënë autorizim i plotë për qasje në llogarit duke përfshirë të drejtën e deponimit dhe tërheqjes së parave, e cilën llogari i akuzuari K.P., e ka shfrytëzuar në procedurën e kompensimit të dëmeve për rastet e H.H. (tani i ndjerë), ku si i dëmtuar ka qenë kompania e sigurimeve “Kosova”, në likuidim.

Ankesa pretendon se edhe të dëmtuarit janë paraqitur gabimisht në cilësinë e të dëmtuarve dhe në grupin e parë e përbëjnë personat të cilët vetë kanë qenë të dëmtuara dhe kanë realizuar kompensimet e dëmeve, ndërsa në grupin e dytë janë personat të cilët fare nuk janë paraqitur me kërkesa të tilla dhe asnjëherë nuk kanë marrë autorizim që në emër të tyre të paraqitet ndonjë kërkesë. Ankesa pretendon se i vetmi person i dëmtuar në këtë çështje penale është kompania e sigurimeve “Kosova”.

Në ankesë pretendohet se edhe konfiskimet e dobisë pasurore janë të pabazuara. Banesa në Klinë, në sipërfaqe prej 36^{m²}, është blerë para periudhës kohore të përfshirë në aktakuzë me ddt.24.08.2001, pra 11 muaj para periudhës së përfshirë në aktakuzë. Lokali afarist në Klinë në sipërfaqe prej 11.40^{m²}, është blerë në janar të vitit 1998, shumë kohë para veprave penale të dyshuara, i cili lokal është shitur nga K.P., në shumë prej 28.000Euro, edhe një lokal tjetër ka qenë i blerë para lufte dhe është shitur për 35.000Euro, dhe me këto të holla K.P., ka mbyllë kredinë me të cilin kishte blerë auT.jetin “Audi 6”

Lidhur me lokalin afarist, “Dëshmorët e Kombit”, në sipërfaqe prej 39.86^{m²}, kontratat është lidhur me dt. 10.11.1997 në mes të Gjuro Spasiq si shitës dhe K.P. si blerës ndërsa e njëjta është konvaliduar në gjykatë me 01.11.2005, dhe se ky lokal është blerë para lufte në këtë qendër, mirëpo, ka qenë e pa finalizuar për shkak të gjendjes së luftës.

AuT.jeti "Audi 6", është konfiskuar në mënyrë jo ligjore, për arse se me 07.05.2017, ky auT.jet është blerë me kredi bankare, e cila kredi është mbyllur me shitjen e dy lokaleve afariste.

Lidhur me vendimin e për konfiskimin e mjeteve financiare në emër të shitjes së dy lokaleve, mbrojtja konsideron se këto lokale janë blerë para lufte, prandaj propozimi për konfiskimin e mjeteve financiare është tërësisht i pa bazuar. Prokurori dhe gjykata në asnjë fazë të procedurës penale, nuk ka vlerësuar në ekspertizë vlerën e përfuturit që pretendohet se është përfituar me veprën penale nga ana e të akuzuarit K.P., në shumë prej 1.200.000Euro.

Lidhur me konfiskimin e sendeve është shkelur ligji penal mbi të drejtat e personave të tretë dhe sendet të cilat nuk janë rezultat i veprës penale nuk mund të merren kur nuk janë në fund të kryesit dhe ky fakt nuk është vërtetuar në gjykatën e shkallës së parë.

Lidhur me vendimin mbi sanksionet penale, mbrojtja pretendon se gjykata nuk ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese dhe janë mbi vlerësuar rrethanat rënduese, e sidomos nuk ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese me rastin e shqiptimit të sanksionit penal, si nga koha e kryerjes së veprës penale, deri në shqyrtimin e sanksionit penal, ka kaluar një kohë e gjatë, si dhe nuk ka vlerësuar rrethanën se i akuzuari K.P., është penduar për veprimet e tija, ka kërkuar falje dhe ka treguar gatishmëri për bashkëpunim me gjykatën, e të cilën e pranon edhe vet gjykata e shkallës së parë.

Këto pretendime ankimore gati në tërësi në mënyrë të ngjashme apo të njëjtë janë përshkruar edhe në ankesën e të akuzuarit K.P..

Gjykata e Apelit duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar sipas pretendimeve ankimore të mbrojtësit të akuzuarit dhe vet të akuzuarit K.P., edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 384 par.1 të KPP, gjen se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par.1.12 lidhur me nenin 6 dhe 7 të KPP dhe par.2 të nenit 384 të KPP-së, për pjesën dënuese të përshkruar si në dispozitivet I, II dhe III të aktgjyimit për veprat penale nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësor nga neni 432 të KPRK, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPRK dhe veprës penale pastrimi i parave nga neni 56 par.1 nën par.1 të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, përveç (shtëpisë prej dy kateve ,ne sipërfaqe ne 209^{m2}, e cila evidentohet si parcelë me nr.xxx dhe nr.xxx, Komuna Kadastrale Klinë, dhe tokë bujqësore në sipërfaqe prej 1182^{m2} e regjistruar në certifikatën e pronësisë ULxxx), dhe për pjesën liruese të përshkruar si në dispozitivin IV të aktgjyimit për veprën penale shmangia nga tatimi nga neni 313 par.2 lidhur me par.1 të KPRK.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, si për pjesën dënuese ashtu edhe për liruese gjykata ka dhëna arsye të qarta dhe të plotë rreth argumentimit të kryerjes së veprës penale nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësor nga neni 432 të KPRK, të përshkruar si në dispozitivin I, për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPRK, të përshkruar në afër si në dispozitivin II dhe për veprën penale pastrimi i parave nga neni 56 par.1 nën par.1 të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, të përshkruar si në dispozitivin III të aktgjyimit, e kjo mbështetet në provat dhe dëshmitë e nxjerra në shqyrtim gjyqësor të cilat prova argumentohen me faktet vendimtare se i

akuzuari K.P., bazuar në aktgjykimin çështjen civil C.nr.54/2000, ka nxjerr vendim marrëveshje shtesë gjyqësore me numrin e lëndës C.nr.285/2005, me të cilën aprovon pagesën dyfish të pabazuar, ku Z.M., paraqitet në cilësi të avokatit, i cili përfaqëson familjen G., pa marrë pjesë fare në seanca gjyqësore, e mbi bazën e një autorizimi të falsifikuar, të cilin fakt nuk e ka ditur Z.M., ndërsa L.P., në cilësi të avokatit ka përfaqësuar rastin familja G., e në bazë të lëndës C.nr.54/2000, në bazë të autorizimit të falsifikuar e të cilin fakt nuk e ka ditur L.P., ku i akuzuari K.P., ka qenë në dijeni lidhur me këto fakte se autorizimet të dhëna Z.M. dhe L.P., nuk kishin autorizime dhe kompetencë ligjore për ti përfaqësuar palët në gjykatë, të Rr. dhe Q.G., dhe familjes G. (B.i G.) ku vllau i tij Sh. G., kishte humbur jetën dhe i akuzuari nxjerr vendime të kundërligjshme ku në rastin C.nr.54/2000, të cilën ishte angazhuar L.P., ka aprovuar kompensimin në shumë prej 56.000Euro, ndërsa në rastin i cili ishte angazhuar Z.M., kishte aprovuar kompensim në shumë prej 61.536,47Euro, të cilat mjete financiare në cilësinë e zyrtarit të kompanisë së sigurimeve “Kosova”, e cila ishte në likuidim tani i ndjeri H.H., i ka transferuar në llogaritë bankare gjoja të avokatëve dhe atë në llogari të Z.M.t, me nr.1110-166329-000105, dhe në llogari të L.P., me numrin e llogarisë 1132145628000182, e të cilat mjete në fund sipas autorizimit janë tërhequr apo dorëzuar të akuzuarit K.P., si përfitim i dobisë së kundërligjshme pasurore.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit këto fakte se i akuzuari i ka kryer veprat penale për të cilat është shpall fajtor argumentohen nga vetë deponimet e dëshmitarëve Q.G., i cili në shqyrtimin gjyqësor vërteton se vllau i tij R. G., ka pasuar aksident komunikacioni në vitin 1996, ku kanë mbetur të dy të lënduar, mirëpo, lidhur me këtë çështje asnjëherë nuk ka iniciuar ndonjë rast të kompensimit të dëmit, gjithashtu edhe pas luftës nuk ka iniciuar rast për kompensimin e dëmit dhe se asnjëherë nuk ka autorizuar në cilësi të avokatit L.P. ,e edhe përfaqësuesi L.P., fare nuk e ka njohur, e kjo mbështetet edhe në deklaratën e av.B.G., i cili vërteton se e ka përfaqësuar familjen G. si palë të dëmtuar dhe familjes G. në emër të kompensimit të dëmit u ka dorëzuar shumën prej 11.900,000Euro, ndërsa në emër të shërbimeve si avokat ka ndalur shumën prej 20%, e në rastin e njëjtë tani angazhohet Z.M., që të përfaqësoj familjen G. dhe si kompensim të cilin e kishte aprovuar i akuzuari Z.M., ati i kompensohet shuma prej 61.536.47Euro, ndërsa për Rr. dhe Q.G., është kompensuar shuma prej 56.000Euro. e në bazë të këtyre autorizimeve janë nxjerrë vendime gjyqësore C.nr.282/2005, dhe C.nr.54/2000, e të cilat mjete financiare nga H.H. si Zyrtar i Kompanisë së Sigurimeve “Kosova”, e cila ishte në likuidim , janë transferuar në llogari të Z.M. dhe L.P., dhe ata në shqyrtimin gjyqësor vërtetojnë se Z.M., asnjëherë nuk ka marrë pjesë në seancat gjyqësore si përfaqësues i palës së dëmtuar dhe për këto asnjëherë nuk kanë ditur Z.M. L.P., e kjo mbështetet edhe në transaksionet bankare të bëra në llogarinë e Z.M., nga K.P., ku mjetet financiare janë deponuar në llogarinë e Z.M. nga përfaqësuesi i kompanisë tani të ndjerit H.H., në shumën prej 61.536.47Euro, të cilat të holla i tërheq i akuzuari K.P., ku 17.000Euro, ia jep avokatit B.G., për palën e dëmtuar R. G., si kryefamiljar e pastaj av.B.G., shumën prej 11.900Euro, ia dorëzon R. G. si palë e dëmtuar. E gjithë kjo ujdj gjyqësore është lidhur pa dijeninë e familjes së dëmtuar dhe pa dijeninë e Z.M.t, i cili në shkresat e lëndës ka pasur të deponuar autorizimin e falsifikuar nga i akuzuari K.P..

Për me tepër këto fakte mbështeten edhe në atë se i akuzuari K.P., ka plotësuar me shkrim dore 19 autorizime, të cilat një pjesë ia jep Z.M.t, të cilin fakt e pranon edhe vet i akuzuari, e cila mbështetet edhe në ekspertizën grafologjike dhe dëshmitë e ekspertëve se autorizimet janë të falsifikuara, gjykata ka dhënë arsye të qarta dhe të plota , se i akuzuari K.P., i ka falsifikuar autorizimet e qëllimi i tij, ka qenë përfitimi i dobisë pasurore në mënyrë të

kundërligjshme, e në këtë mënyrë duke vu në lajthim kompaninë e sigurimeve “Kosova” e duke ditur se e njëjta ka qenë në likuidim, dhe gjykata lidhur me këto fakte ka dhënë arsye të plota rreth argumentimit se të gjitha mjetet financiare e bazuar e bazuar në dokumentacion të falsifikuar në emër të palëve të cilat kanë qenë në procedurë, dhe të gjitha pagesat rrjedh se janë kryer nëpërmjet të Z.M.t, në llogaritë e të cilëve pagesa ka pasur autorizim edhe i akuzuari K.P.. Këto mjete finacijare- paratë i akuzuari K.P., i ka tërhequr nga llogaria e Z.M.. Gjykata në mënyrë të argumentuar vërteton faktin se të gjitha kompensimet të cilat janë kryer në emër të palëve të dëmtuara, i akuzuari K.P. e ka ditur se të gjitha këto pagesa janë bërë në pajtim me tani të ndjerin H.H., i cili ka qenë si likuidator në kompaninë e sigurimeve “Kosova” dhe të gjitha të hollat nga “Procredit Bank”, i ka tërhequr i akuzuari K.P., e në bashkëpunim me tani të ndjerin H.H. e për të cilat i akuzuari ka pas dijeni të plotë.

Gjykata ka dhënë arsye të qarta dhe të plota lidhur edhe me falsifikimet për veprën penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare ku vetë i akuzuari K.P., deklaron se në cilësinë e gjyqtarit ka plotësuar 19 autorizime ku një pjesë prej tyre ia ka dhënë edhe Z.M.t, e përveç kësaj gjykata e shkallës së parë, lidhur me konfiskimin e dobive pasurore të akuzuarit K.P., e në bazë të veprës penale pastrimi i parave nga neni 56 par.1 nën par.1 të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, ka dhënë arsye të qarta dhe të plota rreth konfiskimit të pasurive dhe konfiskimit të dobive pasurore, Banesë në Klinë në rr. “Dëshmorët e Kombit”, banesa nr.6, Hyrja 2, Kati 1, Blloku P+3, në sipërfaqe prej 36^{m2}, e blerë sipas kontratës së datës 17.04.2003, e vërtetuar në gjykatë nën numrin Vr.nr.629/2003, shitës P.Z. ndërsa blerës K.P., në çmimin e përgjithshëm prej 12.000Euro, Banesë në Prishtinë, Lagjja “Ulpiana”; në Prishtinë, objekti E-30, Lamela 1, banesa nr.4, kati përdhese, në sipërfaqe prej 97.30^{m2}, e blerë sipas kontratës Vr.nr.9859/2007, e dt.09.11.2007, e lidhur ndërmjet A.J., si shitës dhe L.P., si blerës i banesës në vlerë prej 125.000Euro, Patundshmërinë (në të cilën është e ndërtuar një shtëpi) në Ulqin, të Malit të Zi, në sipërfaqe prej 308^{m2}, parcela nën numrin 108 Zona kadastrale në Ulqin, patundshmëri e blerë nën kontratën me numër 3852/2006, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Ulqin, e lidhur me dt.08.09.2006, ndërmjet K.P., si blerës dhe Zh.B., si shitës, e cila patundshmëri është transferuar në emër të mikut të K.P., I.G., me qëndrim në Australi, Patundshmëri (livadh) në Ulqin të Malit të Zi, në sipërfaqe prej 171^{m2}, parcela nën numrin 107 Zona Kadastrale Ulqin, patundshmëri e blerë me kontratën me numër 3191/2006, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Ulqin, e lidhur me dt.07.08.2006, ndërmjet K.P., si blerës dhe B.P., si shitës, e cila patundshmëri është regjistruar në emër të babait të K.P., Z.P., përveç (Shtëpisë prej dy kateve, në sipërfaqe prej 209^{m2}, evidentuar si parcela nën numrin xxx dhe xxx, Komuna Kadastrale Klinë, si dhe tokë bujqësore në sipërfaqe prej 1182^{m2}, e regjistruar në Certifikatën e Pronësisë UL-71006024-00916), Lokal afarist i cili gjendet në rr. “Dëshmorët e Kombit”, në Klinë, lamela A, banesa nr.1, Kati përdhese, në sipërfaqe prej 39.86^{m2}, e blerë sipas kontratës së vërtetuar në Gjykatën Komunale në Klinë, nën numrin Vr.nr.1771/2005, e dt.01.11.2005, lidhur ndërmjet K.P., si blerës dhe S.Gj., si shitës, e cila tani figuron në emër të T.P.(vëllait të K.P.), AuT.jeti “Audi A6”, me targa të regjistrimit 03-310-A1, i blerë nga K.P., i cili gjendet në emër të mikut të K.P., K.G. dhe mjetet financiare nga shtija e dy lokaleve afariste, paraprakisht të blerë nga K.P., në vlerë prej 35.000Euro, për njërin lokal dhe 28.000Euro, për lokalin tij.

Pretendimet ankimore se është dashur patjetër të sigurohen autorizimet origjinale janë të papabazuara kjo për faktin se vet i akuzuari në mbrojtjen e tij deklaron se vet i ka plotësuar 19 autorizime ku një pjesë prej tyre ia ka dhënë edhe Z.M. , ndërsa të tjerat i ka mbajtur për vete, ndërsa edhe për kontratat me VR.nr.278/2004, të dt.23.02.2004, dhe kontratën Vr.nr.3274/2009,

të dt.19.11.2009, të cilat janë vërtetuar në Gjykatën Komunale në Klinë janë të paraqitura në ankesë në fotokopje , të cilat paluejtëshëmëri janë kthyer në posedim të akuzuarit, janë fakte të cilat janë të provuara dhe për to dihen dhe ato nuk provohen si pretendohet në ankesa.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit edhe për pjesën liruese gjykata e shkallës së parë, për veprën penale shmangia nga tatimi nga neni 313 par agrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, ka dhënë arsye të qarta dhe të plota sepse është shumë e logjikshme për veprat penale për të cilat i akuzuari është shpallur fajtor, me pagimin e tatimeve veprat penale dot ë ishin legalizuar dhe gjykata drejt ka vepruar që për këtë vepër të akuzuarin K.P. e ka liruar nga akuza.

Nga ajo që u cekë më lartë rezulton se pretendimet ankimore në të dy ankesat e paraqitura se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkeljet esenciale të procedurës penale, qofshin ato të natyrës absolute apo relative janë të pa qëndrueshme, nga neni 384 par.1 dhe 2 nën par.1.12 e në lidhje me nenin 370 par.6 dhe 7 të KPP.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore të paraqitura në dy ankesat të mbrojtësit të akuzuarit K.P. dhe vet të akuzuarit, janë të pabazuara , dhe gjykata e shkallës së parë, drejt ka vërtetuar se i akuzuari nga dt.04.06.2008, në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës Komunale në Klinë, nxjerr vendim mbi kompenzimin e dëmit të familjes Rrushtem e Q.G., në çështjen civilë C.nr.54/2000, dhe gjykata drejt ka vërtetuar se në këtë çështje i akuzuari K.P., ka nxjerr vendim (marrëveshje shtesë gjyqësore, në numrin e lëndës C.nr.282/2005), me të cilën aprovon pagesën e dyfishtë të pa arsyetuar, ku Z.M., tani paraqitet si avokat i cili përfaqëson familjen G., e cekur më lartë, e pa marrë fare pjesë në seancat gjyqësore e mbi bazën e autorizimit të falsifikuar e të cilin fakt nuk e ka pasur në dijeni Z.M., ndërsa L.P., në cilësi të avokatit ka përfaqësuar rastin, e po ashtu L.P., në cilësinë e avokatit ka përfaqësuar rastin “të familjes G.”, sipas lëndës civile C.nr.54/2000, e në bazë të autorizimit të falsifikuar e për të cilin nuk ka pasur dijeni L.P., ndërsa K.P., i ka ditur këto fakte mbi kundërligjshmërinë e autorizimeve të dhëna Z.M. dhe L.P., të cilët nuk kanë pasur asnjë kompetencë ligjore për ti përfaqësuar palët në çështje civile dhe gjykata drejt ka vërtetuar se i akuzuari K.P., me qëllim të përfitimit të pasuror të kundërligjshëm, me dijeninë e tij të plotë, e nxjerr vendim të kundërligjshëm dhe në çështjen civile C.nr.54/2000, në të cilën si i autorizuar ishte angazhuar L.P., ka aprovuar kompensim në shumë prej 56.00,00Euro, ndërsa në rastin me të cilin ishte angazhuar si përfaqësues Z.M., i akuzuari K.P., ka aprovuar një kompensim prej 61.536,47Euro, të cilat mjete financiare H.H., në cilësinë e zyrtarit të kompanisë së sigurimeve “Kosova”, e cila ka qenë në likuidim i ka transferuar në llogaritë bankare të Z.M. në nr.1110-166329-000105 dhe në llogari të L.P., me numër të llogarisë 1132145628000182, e mbi autorizimet të cilat i ka pasur i akuzuari K.P., ato janë dorëzuar dhe tërhequr dhe të njëjtat i akuzuari i ka fituar në mënyrë të kundërligjshme për veten e tij.

Po ashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar gjendjen faktike se me dt.18.11.2002, deri me dt.18.12.2007, i akuzuari K.P., me shfrytëzimin e pozitës së tij si gjyqtar, ka përdorur vulën zyrtare të Gjykatës Komunale në Klinë, dhe i vulos 19 autorizime të falsifikuar për përfaqësim ligjor.

Gjykata drejtë ka vërtetuar se të dëmtuarit nga aksidentet e trafikut nuk kanë dhënë pëlqim për përfaqësimet ligjore të tyre dhe vulosja dhe mbushja e autorizimeve me shënime të palëve është bërë nga i akuzuari K.P., që këtyre autorizimeve t’iu epet origjinaliteti dhe të duken

si origjinale dhe në këtë mënyrë janë krijuar dosjet e lëndës e të cilat do ti paraqiten kompanisë së sigurimeve “Kosova”, e cila kompani ka qenë në likuidim dhe në bazë të cilave dosje do të aprovoj formalisht kërkesa për kompensimin e dëmit.

Gjykata drejt ka vërtetuar gjendjen faktike se i akuzuari Z.M. dhe përkundër faktit se ka shërbyer si gjyqtar në rastet në të cilat më pas ishte përfshirë si avokat K.P., i ka dorëzuar kërkesat për kompensimin e dëmeve në kompaninë e sigurimeve “Kosova”, e cila ka qenë në likuidim përfshirë edhe autorizimet e falsifikuara e të cilit fakt të falsifikimit nuk e ka ditur Z.M., e të cilat autorizime ishin përpiluar me dorë dhe vulosur nga K.P., e duke keqpërdorur pozitën e tij si gjyqtar, me shfrytëzimin e vulës së gjykatës, të cilin fakt e pranon edhe i akuzuari se vet i ka plotësuar 19 autorizime ku një pjesë prej tyre ia ka dhënë edhe Z.M.t, ndërsa të tjerat i ka mbajtur për vete

Gjykata drejt ka vërtetuar gjendjen faktike se i akuzuari K.P., nga viti 2002 gjerë në vitin 2008 duke e ditur dhe i vetëdijshëm se parat të fituara nga aktiviteti kriminal, si produkt i këtij aktiviteti, përveç (shtëpisë prej dy kateve, ne sipërfaqe ne 209^{m2}, e cila evidentohet si parcelë me nr.xxx dhe nr.xxx, Komuna Kadastrale Klinë, dhe tokë bujqësore në sipërfaqe prej 1182^{m2}, e regjistruar në certifikatën e pronësisë ULxxx), e me qëllim të fshehjes të prejardhjes të parave nga kompania e sigurimeve “Kosova”, e cila ka qenë në likuidim-para jo ligjore (të pista), e në vlerë prej 1.200.000,00Euro, e me qëllim që këto para ti shndërroj dhe të duken se janë ligjore bënë pastrimin e parave dhe blerë prona dhe gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur pronat dhe mjetet financiare të konfiskimit të dobisë pasurore të fituara me vepra penale i konfiskon dhe atë: banesë në Klinë në rr. “Dëshmorët e Kombit”, banesa nr.6, Hyrja 2, Kati 1, Blloku P+3, në sipërfaqe prej 36^{m2}, e blerë sipas kontratës së datës 17.04.2003, e vërtetuar në gjykatë nën numrin Vr.nr.629/2003, shitës P.Z. ndërsa blerës K.P., në çmimin e përgjithshëm prej 12.000Euro, banesë në Prishtinë, Lagjja “Ulpiana”; në Prishtinë, objekti E-30, Lamela 1, banesa nr.4, kati përdhese, në sipërfaqe prej 97.30^{m2}, e blerë sipas kontratës Vr.nr.9859/2007, e dt.09.11.2007, e lidhur ndërmjet A.J., si shitës dhe L.P., si blerës i banesës në vlerë prej 125.000Euro, patundshmërinë (në të cilën është e ndërtuar një shtëpi) në Ulqin, të Malit të Zi, në sipërfaqe prej 308^{m2}, parcela nën numrin 108 Zona kadastrale në Ulqin, patundshmëri e blerë nën kontratën me numër 3852/2006, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Ulqin, e lidhur me dt.08.09.2006, ndërmjet K.P., si blerës dhe Zh.B., si shitës, e cila patundshmëri është transferuar në emër të mikut të K.P., I.G., me qëndrim në Australi, patundshmëri (livadh) në Ulqin të Malit të Zi, në sipërfaqe prej 171^{m2}, parcela nën numrin 107 Zona Kadastrale Ulqin, patundshmëri e blerë me kontratën me numër 3191/2006, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Ulqin, e lidhur me dt.07.08.2006, ndërmjet K.P., si blerës dhe B.P., si shitës, e cila patundshmëri është regjistruar në emër të babait të K.P., Z.P.,përveç (shtëpisë prej dy kateve, ne sipërfaqe ne 209^{m2}, e cila evidentohet si parcelë me nr.xxx dhe nr.xxx, Komuna Kadastrale Klinë, dhe tokë bujqësore në sipërfaqe prej 1182^{m2}, e regjistruar në certifikatën e pronësisë ULxxx), lokal afarist i cili gjendet në rr. “Dëshmorët e Kombit”, në Klinë, lamela A, banesa nr.1, Kati përdhese, në sipërfaqe prej 39.86^{m2}, e blerë sipas kontratës së vërtetuar në Gjykatën Komunale në Klinë, nën numrin Vr.nr.1771/2005, e dt.01.11.2005, lidhur ndërmjet K.P., si blerës dhe S.Gj., si shitës, e cila tani figuron në emër të T.P.(vëllait të K.P.), auT.jeti “Audi A6”, me targa të regjistrimit 03-310-A1, i blerë nga K.P., i cili gjendet në emër të mikut të K.P., K.G., mjetet financiare nga shtija e dy lokaleve afariste, paraprakisht të blerë nga K.P., në vlerë prej 35.000Euro, për njërin lokal dhe 28.000Euro, për lokalin tjetër.

Pretendimet ankimore në të dy ankesat e paraqitura të mbrojtësit të akuzuarit dhe vet të akuzuarit K.P., se është shkelur ligji penal, nga neni 385 par.1 të KPP, në të cilën gjykata shikon dhe sipas detyrës zyrtare është e pa bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit dhe provave të nxjerra në shqyrtimin gjyqësor dhe veprimeve të cilat i ka ndërmarr i akuzuari për veprat penale për të cilat është shpallur fajtor, rezulton se gjykata e shkallës së parë, drejt ka aplikuar Ligji Penal edhe për veprat penale nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore nga neni 432 të KPRK-së, veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPRK-së, si dhe për veprën penale të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit gjykata ka aplikuar drejt ligjin penal, e cila është e pranueshme edhe për Gjykatën e Apelit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit se dhe pretendimeve ankimore se nuk përmbushen elementet e veprave penale nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore nga neni 432 të KPRK-së, veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPRK-së, apo ekziston ndonjë vepër tjetër penale, Gjykata e Apelit, vlerëson se nga përshkrimet faktike në dispozitivin I dhe II të aktgjykimit, për të cilat i akuzuari është shpallur fajtor, shihet se kemi të bëjmë me vepra penale të falsifikimit të dokumenteve, mirëpo, në esencë për të dy veprat penale të përshkruara si në dispozitivit, e për të arritur qëllimin e përfitimit të dobisë pasurore, këto vepra penale mund të jenë në bashkim ideal me veprën penale të mashtrimit, për arsye se për nxjerrjen e kundërligjshme të vendimeve gjyqësore dhe keqpërdorimin e detyrës zyrtare (mshihet) falsifikimi si në dispozitivin I dhe II edhe të aktgjykimit C.nr.54/2000, dhe 19 autorizimeve, e që në të dy rastet kemi të bëjmë me pozitën zyrtare të vet të akuzuarit K.P., me qëllim që nëpërmjet këtyre veprimeve inkriminuese të vijë gjerë te përfitimi i kundërligjshëm i dobisë pasurore, sepse po mos të kishte marrë këto veprime (të kamufluara), e të cilat në shikim të parë shihet se përmbajnë elementet e veprës penale të falsifikimit, i akuzuari nuk kishte me arritur qëllimin e dobisë pasurore dhe kjo në esencë të çështjeve penale për të cilat i akuzuari K.P., është shpallur fajtor si në dispozitivin I dhe II të aktgjykimit, në tërësi përmbushen elementet e veprave penale nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore nga neni 432 të KPRK-së dhe veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPRK-së.

Gjykata e Apelit, për veprën penale pastrim i parave të përcaktuar sipas nenit 56 paragrafi 1 të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, e më afër të përshkruar si në dispozitivin III, se në këtë kohë nuk ka ekzistuar Ligji. Dhe sipas ankesave i akuzuari K.P., pa ekzistuar ligji është shpallur fajtor për veprën penale është e pabazuar. Sipas Gjykatës së Apelit, kjo vepër penale ka qenë e sanksionuar edhe për kohën kur i akuzuari K.P., ka kryer veprat penale, e sipas Rregullores së UNMIK-ut 2002/2, lidhur me shpëlarjen e parave e paraparë në nenin 10.02 e cila ka rregulluar çështjen e pastrimit të parave, që nënkupton përfitimet pasurore të fituara në mënyrë të kundërligjshme (në mënyrë të pistë), për të shndërruar në përfitime të rregullta ligjore, i akuzuari ka blerë pasuri dhe paluajtshmeri të ndryshme që këto para të fituara në mënyrë jo ligjore ti shndërroj dhe të duken se ata janë fituar në mënyrë ligjore, duke investuar në paluajtshme ri të cilat janë blerë nga vetë i akuzuari dhe nëpërmjet personave të tretë dhe nga kjo del se gjykata e shkallës së parë, në të tri veprat penale të përshkruara si në dispozitivin I,II dhe III të aktgjykimit, përveç (shtëpisë prej dy kateve, ne sipërfaqe ne 209^{m2}, e cila evidentohet si parcelë me nr.xxx dhe nr.xxx, Komuna Kadastrale Klinë, dhe tokë bujqësore në sipërfaqe prej 1182^{m2}, e regjistruar në certifikatën e pronësisë është ULxxx), dhe për pjesën

liruese për veprën penale më afër të përshkruar si në dispozitivin IV të aktgjykimit, gjykata drejt ka aplikuar Ligjin Penal.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk kemi parashkrim të ndjekjes penale siç pretendohet në të dy ankesat kjo për arsye se nga përshkrimet faktike dhe nga shkresat e lëndës dhe nga provat e nxjerra në shqyrtime gjyqësore rezulton se veprimet janë ndërmarrë në vazhdimësi dhe vendimi për veprën penale nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësor nga neni 432 të KPRK; është marrë me dt.04.06.2008, e në bazë të lëndës së çështjes civile C:nr.54/2000, mbi të cilën lëndë janë bërë veprime të kundërligjshme me qëllim të dobisë pasurore, ndërsa sa i përket veprës penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 442 të KPRK, edhe në këtë çështje penale veprimet janë inkriminuese janë ndërmarrë nga i akuzuari në vazhdimësi e nga kjo rrjedh dhe se veprimi i fundit është ndërmarr me dt.18.12.2007, e njëjta gjendje paraqitet edhe në çështje penale, të veprës penale pastrim i parave të përcaktuar sipas nenit 56 par 1 të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit dhe veprimi i fundit është marrë në vitin 2008 dhe nga kjo rezulton se në kohën kur është marrë vendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe gjerë në vendosje në gjykatën së shkallës së dytë, sipas mjeteve juridike-ankesave të paraqitura, nuk kemi të bëjmë me parashkrim të ndjekjes penale, si pretendohet në ankesat e paraqitura.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke u nisur se parashkrimi llogaritet prej kohës së kryerjes së veprës penale, e meqë këto vepra penale dhe veprimet inkriminuese kanë qenë në vazhdimësi dhe fillimi i llogaritjes i afatit të parashkrimit të ndjekjes penale llogaritet prej kohës, kur është kryer vepra penale, ndërsa sipas shkresave të lëndës dhe përshkrimeve faktike të veprimeve të akuzuarit K.P. veprimet nga ana e tij janë marrë në kontiunitet dhe në vazhdimësi, rrjedh se nuk kemi të bëjmë me parashkrimin e ndjekjes penale.

Gjykata e Apelit vlerëson, se për veprën penale të pastrimit të parave të përcaktuar sipas nenit 56 paragrafi 1 të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, gjykata drejt ka aplikuar ligjin penal, përveç (shtëpisë prej dy kateve ,ne sipërfaqe ne 209^{m2}, e cila evidentohet si parcelë me nr.xxx dhe nr.xxx, Komuna Kadastrale Klinë, dhe tokë bujqësore në sipërfaqe prej 1182^{m2}, e regjistruar në certifikatën e pronësisë ULxxx), dhe gjykata e ndryshoi aktgjykimin lidhur me konfiskimin e dobisë pasurore për këtë pjesë për arsye se nga shkresat e lëndës rrjedh se kjo paluajtshmëri është blerë nga M.M., nga Klina, e cila paluajtshmëri është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Klinë, me Vr.nr.278/2004, të dt.23.02.2004, pra, më herët se kur janë nxjerrë vendimet marrëveshjet shtesë gjyqësore në vitin 2005, e cila paluajtshmëri me kontratën mbi shkëputjen e bashkësisë familjare dhe ndarjen fizike të patundshmërisë, është bërë ndarja fizike e patundshmërive e bashkë me te edhe bashkësisë familjare, dhe i akuzuari është ndarë me vllaun e tij T. Z.P., e cila kontratë është vërtetuar me Vr.nr.3274/2009, të dt.19.11.2009, në Gjykatën Komunale në Klinë, e duke marrë parasysh faktin se edhe përkundër asaj se ekzistojnë dy kontrata njëra mbi shitblerjen e patundshmërisë, dhe kontrata tjetër mbi shkëputjen e bashkësisë familjare dhe ndarjen fizike të patundshmërisë , gjykata e ndryshoi aktgjykimin lidhur me konfiskimin e dobisë pasurore për këtë pjesë. Gjykata e Apelit, vlerëson se në rastet kur ekzistojnë mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve vendimtare , nga e cila varet çështja e zbatimit të ligjit, (e në çështjen penale të dy kontratat janë të vërtetuara), ato interpretohen gjithmonë në favor të akuzuarit siç është paraparë me dispozitat e Kodit Penal dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe për këto arsye Gjykata e Apelit, e ndryshoj aktgjykimin.

Gjykata e Apelit e ndryshoj edhe vendimin mbi dënimin e shqiptuar me gjobë ,e me aplikimin e ligjit më të favorshëm për të akuzuarin sipas dispozitës së nenit 3 par 1 të KRPK , për arsye se dënimi i shqiptuar prej 5,000.00 euro(pesëmijë euro)e të cilin dënim, nëse nuk e paguan i akuzuari në afatin e caktuar i zëvendësohet një ditë burgim me 20 (njëzet euro) ose me 250 ditë gjë që i bie se i akuzuari është dashtë ti mbaj 8(tetë) muaj e 10 (dhjetë)ditë. Ndërsa sipas dispozitës nenit 3 par 1 të KRPK-së ,ndaj kryesit zbatohet dispozitat ligjore në kohën e kryerjes së verës penale ,e nga shkresat e lëndës del se aktakuza e ndryshuar është ngritur nga PSKR-së, me dt.29.12.2015. Nga kjo rezulton se si ligj më i favorshëm për të akuzuarin Kol Puka është dispozita e nenit 39 par 4 të KPK –së(Kodi i vjetër) e cila parasheh se zëvendësimi i dënimit me gjobë me dënim burgimi, të mos të tejkaloj 6 (gjashtë)muaj.

Me ndryshimin e konfiskimit të dobisë pasurore për pasurin e konfiskuar shtëpinë prej dy kate ,ne sipërfaqe ne 209^{m2}, e cila evidentohet si parcelë me nr.xxx dhe nr.xxx, Komuna Kadastrale Klinë, dhe tokë bujqësore në sipërfaqe prej 1182^{m2}, e regjistruar në certifikatën e pronësisë ULxxx, e më afër të përshkruar si në dispozitivn III, pasusi pesë, të cilat paluajtshmëri janë kthyer në posedim të akuzuarit K.P., si dhe me ndryshimin e vendimit mbi dënimin e shqiptuar me gjobë e që janë cekur më lartë, gjykata e evitoi shkeljen e ligjit penal, nga neni 385 par.1 të KPP.

Gjykata e Apelit duke vlerësuar ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar të S.Gj., av.Z.P., ankesën e njëjta e ka hedhur si të pa lejuar, për arsye se përfaqësuesi i palës së dëmtuar ka ushtruar ankesë për realizimin e kërkesës pasurore juridike, e për të cilin i dëmtuari S.Gj., është udhëzuar në kontest të rregullt civil, ndërsa kundër aktgjykimit me të cilin i akuzuari K.P., shpallet fajtor të drejtën për ushtrimin e ankesës lidhur me kërkesën pasurore juridike ka të drejtë të ushtroj i akuzuari, mbrojtësi i tij, prokurori i shtetit, por jo edhe i dëmtuari, për faktin se i dëmtuari është udhëzuar në kontest civil dhe nuk i cenohet asnjë e drejtë ligjore dhe për këtë arsye ankesa është hedhur poshtë si e palejuar.

Sa i përket bazës ankimore të vendimit mbi dënimin dhe konfiskimit të dobisë pasurore, Gjykata e Apelit, rrethanat rënduese dhe lehtësuese të cilat janë marrë nga gjykata e shkallës së parë, i merr si të vërtetuara, kjo për arsye se gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të dënimit ka marrë parasysh rregullat e përgjithshme mbi matjen e dënimit, të cilat janë paraparë si në nenin 73 të KPRK-së dhe gjykata në mënyrë të drejtë ka vlerësuar peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë dhe sjelljet e të akuzuarit pas kryerjes së veprës penale, e duke marrë parasysh kohën e kryerjes të veprave penale e gjer në ditën e shqiptimit të dënimit ka kaluar kohë e gjatë, Gjykata e Apelit, e ndryshoi aktgjykimi lidhur vetëm me vendimin për dënim, ashtu që të akuzuarit K.P., ia shqiptoj dënimin me burgim unik në kohëzgjatje prej 3(tre)vite e 6(gjashtë)muaj dhe dënimin me gjobë në shumë prej 3.000(tremijë)Euro, si dhe konfiskimin e dobive pasurore të kryer me vepra penale dhe dënimi unik i shqiptuar me burgim dhe me gjobë si dhe konfiskimi i dobisë pasurore, është në përpjesëtim me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, për arsye se në asnjërën ankesë nuk janë paraqitur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese që kishte me ndikuar në zbutjen e dënimit, për veprën penale për të cilat i akuzuari është shpallur fajtor dhe dënimi i shqiptuar me burgim dhe me gjobë, si dhe konfiskimi i dobisë pasurore, nga i akuzuari K.P., sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duhet të ndikojë pozitivisht te i akuzuari, që në të ardhmen të mos kryejë vepra penale të këtilla apo të ngjashme, preventive individuale, si dhe që edhe të tjerat të përmbahen nga kryerja e veprave të

tilla penale, preventive e përgjithshme e që të dyja kanë për qëllim parandalimin e veprave penale dhe pritet që të arrihet edhe qëllimi i dënimit të paraparë si në nenin 41 të KPRK-së.

Prandaj, nga arsyet e përshkruara më lartë, u deshtë që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të ndryshohet me aprovimin e ankesave të akuzuarit dhe të mbrojtësit të tij, vetëm mbi sanksionin penal, e në bazë të nenit 403 par.1 të KPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.486/17, me dt.20.11.2017

Procesmbajtësi
Leonita Lajqi

Anëtarët e kolegjit
Fillim Skoro

Kryetari i kolegjit,
Abdullah Ahmeti

Driton Muharremi
